



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 455/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                 |            |
|-----------------|------------|
| Evis Shurdha    | Kryetar    |
| Leonard Gremshi | Zv/Kryetar |
| Hektor Balluku  | Anëtar     |
| Kleves Janku    | Anëtar     |
| Odise Moçka     | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 23.06.2017 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

**Objekt:**

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Shëndelli” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Kërkesë me Propozim”, me Nr. REF-74118-03-27-2017, me objekt “Rehabilitim kanali ujitës ura Leshnicë-Cërravë” me fond limit 7,385,206 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

**Ankimues:**

“Shëndelli” sh.p.k  
Ruga “Andon Profka”, Lagjia “Kastrioti”, 2 kullat Fier

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Pogradec  
Bulevardi “Reshit Collaku”, Lagjia nr 2 Pogradec

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.03.2017, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë me Propozim*”, me Nr. REF-74118-03-27-2017, me objekt “*Rehabilitim kanali ujitës ura Leshnicë-Cërravë*” me fond limit 7,385,206 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.04.2017 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Pogradec.

II.2. Në datën 10.04.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, me shkresën 1809/1 prot, datë 17.05.2017 protokolluar me tonën me nr. 916/2 datë 22.05.2017 me objekt “*Në zbatim të vendimit nr. 916/1prot., datë 10.05.2017*”, rezulton se në datën 19.04.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

|                                |                |              |
|--------------------------------|----------------|--------------|
| 1. “Shëndelli” shpk            | 6.519.095 lekë | skualifikuar |
| 2. “Boshnjaku B” shpk          | 7.022.827 lekë | skualifikuar |
| 3. “Bulding Construction” shpk | 7.237.502 leke | kualifikuar  |

II.3. Në datën 19.04.2017 operatori ekonomik ankimes është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

1-Nuk verteton se nuk ka detyrime të tjera prane Bashkise Pogradec sipas kerkesave ne DST.

2-Ne dst eshte kerkuar Pranohet marrja me qira ose huapendorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontrata/t e qiramarrjes ose te huapendorjes te jene te lidhura para noterit per objektin qe prokurohet, me afat vlefshmerie deri ne pefundim te objektit si dhe te shoqerohen nga te gjitha dokumentat e mesiperme te pronesis se huadhenesit, Operatori ekonomik ka paraqitur deklaraten por mjetet e marra me qera nuk jane me destinacion per objektin qe prokurohet sipas kerkesave te dst.

3.Ne dst eshte kerkuar Makineri per betonim monolite per kanale vaditese (IN CALCESTRUZZO MONOLITE) 1 copë Pronësi ose me qera Nga operatori ekonomik nuk eshte paraqitur kjo makineri.

II.4. Në datën 21.04.2017 operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

[...]

Kundërshtimi:

OE "Shëndelli" shpk ka paraqitur document me emërtimin vërtetim Bashkia Pogradec 07.04.201, i cili është një vërtetim nga Bshkia Pogradec të lëshuar më datën 07.04.2017 me nr. 1231/I prot., ku vërtetimi i lëshuar nga AK-ja vërteton se subjekti jonë nuk ka detyrime pranë Bashkisë Pogradec....

Rrjedhimisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.

Në dst është kërkuar pranohet marrja me qira ose huapërdorje e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata /e qiramarrjes ose huapërdorjes të jenë lidhur para noterit për objektin që prokurohet me afat vlefshmërie deri në përfundim të objektit si dhe të shoqërohet nga të gjithë dokumentat e mësipërm të pronësisë ose huadhënësit , operatori ka paraqitur deklaratën për mjetet e marra me qira nuk janë me destinacionin për objektin që prokurohet sipas kërkesave në dst.

Kundërshtimi:

Ju kërkon 4. Dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

| Mjetet   | Sasia  | Gjendja             |
|--|--------|---------------------|
| Kamiona  | 3 copë | Pronësi ose me qera |
| Eskavator  | 2 copë | Pronësi ose me qera |
| Betoniere  | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Autovinç   | 1 copë | Pronësi ose me qera |
| Makineri per betonim monolite per kanale vaditese (IN CALCESTRUZZO MONOLITE) | 1 copë | Pronësi ose me qera |

Oe të paraqesë deklaratën sipas shtojcës nr. 8

Ofertuesi duhet të paraqesë për makineritë të cilat shenohen ne rregjistrin kombetar te automjeteve, lejet e qarkullimit të tyre (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë), Licence dhe certifikat transport mallrash nga Pushteti vendor, Siguracionin, Kontrollin Teknik te automjetit, Taksat e qarkullimit. Për mjetet dhe pajisjet e tjera Ofertuesi duhet të paraqesë kontrate noteriale të blerjes, fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.

*Pranohet marrja me qira ose huaperdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontrata/t e qiramarrjes ose te huaperdorjes te jene te lidhura para noterit per objektin qe prokurohet, me afat vlefshmerie deri ne profundim te objektit si dhe te shoqerohen nga te gjitha dokumentat e mesiperme te pronesis se huadhenesit.*

*Kamiona qe oe "Shëndëlli" ka paraqitur:*

- Komion me targa AA041JB në pronësi shoqëruar me pronësinë leje qarkullimi; siguracion i mjetit (i vlefshëm); taksa certifikata e kontrollit teknik (i vlefshëm)tahografën (i vlefshëm); certifikata e transportit (e vlefshme).*
- Kmion me targa AA599CF në pronësi shoqëruar me pronësinëleje qarkullimi patentë shoferit foto të mjetit siguracionin e mjetit të vlefshëm taksa certifikata e kontrollit teknik e vlefshme tahografën i vlefshëm certifikata e transportit e vlefshme.*
- Komaion me targa AA590DF me kontratë qiraje shoqëruar me kontratën e qirasë që është e vlefshme deri më datën 29.09.2025 leje qarkullimi patentë shoferit pronësinë foto të mjetit tahografën e vlefshëm taksat certifikata e transportit e vlefshme siguracionin e mjetit e vlefshme certifikata e kontrollit teknik e vlefshme.*
- Kamion targa AA291ER me kontratë qiraje shoqëruar me kontratën e qirasë që është e vlefshmederi në datën 24.05.2026 leje qarkullimi patentë shoferit pronësinë fotio të mjetit tahografën e vlefshëm taksa certifikata e transportit e vlefshme siguracioni i mjetit i vlefshëm certifikata e kontrollit teknik i vlefshëm.*
- Kamion me targa FR 3219B me kontratë qiraje shoqëruar me kontratën e qirasë që është e vlefshme deri në datën 14.05.2022 leje qarkullimi patentë shoferit pronësinë foto të mjetit tahografën i vlefshëm taksa certifikata e transportit e vlefshme siguracioni i mjetit i vlefshëm certifikata e kontrollit teknik e vlefshme OE plotëson disponimin e kamiona copë 3. Mjete me qira janë me afate të largët dhe e tejkalon afatin për realizimin e objektit që kërkohet për zbatimin e kontratësafati i cili është 51 dite.Rrjemisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.*

*Kundërshtimi:*

*Eksavator qe ne kemi paraqitur:*

*Dokumenti me mërtrimin Shëndëlli ekskavatori foto shoqëruar me urdhër clirim ftë zhdoganimi modeli i ekskavatorit tipi foto fatura e blerjes mjete është në pronësi.*

*Mjeti me targë FR3810Dnë pronësi shoqëruar me pronësinë leje qarkullimi siguracion i vlefshëm i mjetit taksa certifikata e kontrollit teknik i vlefshëm fatura blerjes.*

*Dokumenti me emërtim Shëndëlli Esk zinxh Frr foto-shoqërohet me kontratë shitblerje për dy mjete 1 fadromë 2 eskavator fletë zhdoganimi urdhër clirimi vërtetim zhdoganimi pagesa e bankës foto pronësi.*

*OE plotëson disponimin e eskavator copë 2. Rrjedhimisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.*

*Kundërshtimi:*

*Dokumenti me emërtim fatura 2; fatura tatimore me nr. 129 datë 17.03.2004 nr. Serie 5654728 oe ankimues ka blerë 1-betonier pa motorrëcopë 1 2- Motorr për betonier copë 2; vibrator thellëse me vibrim copë 2 mjete në pronësi. OE e plotëson disponimin e betoniere copë 1.*

*Rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.*

*Kundërshtimi:*

*Autovinc që oe ka paraqitur:*

*Kamion me targa FR4358D me kontratë qiraje shoqëruaskafr me kontratën e qirasë ë është e vlefshme deri në datën 31.07.202, leje qarkullimi pronësinë foto të mjetit tahografin i vlefshëm taksa certifikata e transportit e vlefshme siguracionin e mjetiot i vlefshëm certifikata e kontrollit teknik e vlefshme.*

*OE plotëson disponimin e autovinc copë 1 qiraja është një afat të largët e tejkalon afatin për realizimin e objektit që kërkohet për zbatimin e objektit afati i cili është 53 dite.*

*Rrjedhimisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.*

*Makineri për betonim monolite për kanale vaditëse që kemi paraqitur:*

*Dokumenti me emërtim fatura 2 fatura tatimore me nr. Fature nr. 129datë 17.03.2004 nr serie 5654728 operatori ankimes ka blerë 1-betonier pa motorr copë 1;2-motorr për betoniere copë 2vibrator thellëse me vibrim copë 2 mjete në pronësi.*

*Dokumenti mëe emërtim fatura 3 fatura tatimore me nr. Fature tatimore me nr fature 402 datë 01.10.2016 nr. Serie 37998402 oe ka blerë lëndë druri (dërrasë për armaturë) mjete në pronësi.*

*OE e plotëson disponimin e makineri për betonim monolite për kanale vaditëse copë 1. Rrjedhimisht skualifikimi për këtë arsye nuk qëndron.*

*Sa më sipër skualifikimi i kryer prej kvo-së se ak-ja Bashkia Pogradec për këtë arsye nuk qëndron pasi nuk përputhet me ato cfarë ju pretendoni në këtë skualifikim dhe ato cfarë ne kemi paraqitur në tender[...]*

II.5. Në datën 02.05.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 1485/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

II.6. Në datën 08.05.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1809/1 prot., datë 17.05.2017, të protokolluar me tonën nr. 916/2prot., datë 22.05.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “3.Ne dst eshte kerkuar Makineri per betonim monolite per kanale vaditese (IN CALCESTRUZZO MONOLITE) 1 copë

*Pronësi ose me qera Nga operatori ekonomik nuk eshte paraqitur kjo makineri.*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” 2.3. “Kapaciteti teknik” pika 4 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

[..]

*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

| Mjetet  | Sasia         | Gjendja                    |
|---|---------------|----------------------------|
| <i>Kamiona</i>  | <i>3 copë</i> | <i>Pronësi ose me qera</i> |
| <i>Eskavator</i>  | <i>2 copë</i> | <i>Pronësi ose me qera</i> |
| <i>Betoniere</i>  | <i>1 copë</i> | <i>Pronësi ose me qera</i> |
| <i>Autovinç</i>   | <i>1 copë</i> | <i>Pronësi ose me qera</i> |
| <i>Makineri per betonim monolite per kanale vaditese (IN CALCESTRUZZO MONOLITE)</i> | <i>1 copë</i> | <i>Pronësi ose me qera</i> |
|   |               |                            |

- *Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr.8*
- *Ofertuesi duhet të paraqesë për makineritë të cilat shenohen ne rregjistrin kombetar te automjeteve, lejet e qarkullimit të tyre (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë), Licence dhe certifikat transport mallrash nga Pushteti vendor, Siguracionin, Kontrollin Teknik te automjetit, Taksat e qarkullimit. Për mjetet dhe pajisjet e tjera Ofertuesi duhet të paraqesë kontrate noteriale të blerjes, fatura tatimore të blerjes ose dokument zhdoganimi të mjetit.*
- *Pranohet marrja me qira ose huaperdorje e mjeteve te mesiperme, me kusht qe kontrata/t e qiramarrjes ose te huaperdorjes te jene te lidhura para noterit per objektin qe prokurohet, me afat vlefshmerie deri ne pefundim te objektit si dhe te shoqerohen nga te gjitha dokumentat e mesiperme te pronesis se huadhenesit.*

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- faturë tatimore shitje me nr. 129 datë 17.03.2004 nr. Serie 5654728 përshkrimi i mallit ose shërbimit: 1-betonier pa motorrë copë 1; 2- Motorr për betonier copë 2; vibrator thellëse me vibrim copë 2;*
- faturë tatimore shitje me nr. 402 datë 01.10.2016 nr. Serie 37998402 përshkrimi i mallit ose shërbimit:Lëndë Druri;*
- faturë tatimore shitje me nr. 168 datë 29.05.2009 nr. Serie 39161881 përshkrimi i mallit ose shërbimit: Pompa uji; tub uji; betoniere; motorra b; minifrezë dore;pompë;ngritës peshe;elektromotors;grup pomp uji 3;*

- iv. *faturë tatimore shitje me nr.48 datë 05.04.2004 nr. Serie 0771350 përshkrimi i mallit ose shërbimit:Skeleri hekuri;skeleri hekuri;vibrator sipërfaqësor;instrument nivelimi;vinc statik;karro dore;*
- v. *faturë tatimore shitje me nr. 36 datë 10.11.2005 nr. Serie 41228523 përshkrimi i mallit ose shërbimit:shkallë të larta;gjenerator rryme;cekc hidraulik;pompë uji moto;sharrë asfatimi prerëse;vinc me krah;aparart saldimi;tobo plastike;karro dore;*
- vi. *faturë tatimore shitje me nr. 2312 datë 27.08.2001 nr. Serie 2498282 përshkrimi i mallit ose shërbimit:hekur;linjë prodhimi duralumini;sharrë;betoniere;autobetoniere;nivelus betoni;armaturë dërrase;*
- vii. *faturë tatimore shitje me nr. 222/1 datë 26.06.2017 përshkrimi i mallit ose shërbimit:cimento;eletropompa;skeleri;depozit uji;motobetoniere; lopata;*
- viii. *faturë tatimore shitje me nr. 331datë 08.11.2011 nr. Serie 41140607 përshkrimi i mallit ose shërbimit:Skel;*
- ix. *faturë tatimore shitje me nr. 20 datë 05.08.2012 nr. Serie 04082520 përshkrimi i mallit ose shërbimit:vinc; prerëse asfati;bolier uji;panel armature;tokmak prerës;lopatë; bela;upa plastike; brav dere e brendshme;rozeta tavani;celës elektrik;lidhës plastik; tel përcjellës;llamp ekon18-26ë;kapak celës prizë;*
- x. *faturë tatimore shitje me nr. 97 datë 11.11.2008 përshkrimi i mallit ose shërbimit:betoniere;motor egisod-...;pompë uji;motor GK;vibrator betoni;mbështetës vibrator;[...]*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

*“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

*b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.5. Në nenin 26, pika 8 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, mjeti i kërkuar në kriteret e vecanta të kualifikimit nga autoriteti kontraktor është *“Makineri për betonim monolite për kanale vaditëse (IN CALCESTRUZZO MONOLITE)”*. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, si dhe pohimit të bërë në parashtrimet me shkrim të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik ankimes *“Shëndelli”* shpk pranë autoritetit kontraktor si dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga vet ankimesi pranohet se ky i fundit nuk disponon mjetin e sipërcituar konkretisht: (*“Makineri për betonim monolite për kanale vaditëse (IN CALCESTRUZZO MONOLITE)”*), por makineri dhe pajisje të tjera të cilat për nga përdorimi dhe funksioni janë të një natyre të ndryshme nga ajo e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit.

III.1.8. Akoma më tej, sqarojmë se në rast se ankimesi do të kishte pretendime në lidhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ai ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në lidhje me pretendimet e tij parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP, ku parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.*

Gjithashtu, në rast se operatori ekonomik ankimes, do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesave për kualifikim, ai mund të paraqiste kërkesë për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave të parashikuar nga neni 42 i LPP-së, ku parashikohet se: *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

III.1.9. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimes në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.



III.1.10. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e “*Makineri për betonim monolite për kanale vaditëse (IN CALCESTRUZZO MONOLITE)*”.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “Shëndelli” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit “*Kërkesë me Propozim*”, me Nr. REF-74118-03-27-2017, me objekt “*Rehabilitim kanali ujitës ura Leshnicë-Cërravë*” me fond limit 7,385,206 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.04.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec,

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Shëndelli” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë me Propozim*”, me Nr. REF-74118-03-27-2017, me objekt “*Rehabilitim kanali ujitës ura Leshnicë-Cërravë*” me fond limit 7,385,206 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.04.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec,
2. Autoriteti kontraktor të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 916 Protokoli Datë 08.05.2017**

#### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

|                        |                       |                     |                    |
|------------------------|-----------------------|---------------------|--------------------|
| <b>Zv/Kryetar</b>      | <b>Anëtar</b>         | <b>Anëtar</b>       | <b>Anëtar</b>      |
| <b>Leonard Gremshi</b> | <b>Hektor Balluku</b> | <b>Kleves Janku</b> | <b>Odise Moçka</b> |

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**